



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU, SPORT
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH, SPORTS

Departamenti i Kulturës / Departman za Kulturu / Department of Culture

Në bazë të rregullores nr. 05/2013 për Ndarjen e Çmimeve për
Dramë Origjinale Shqipe “Katarina Josipi”,
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

shpallë:

K O N K U R S

Ftohen të gjithë dramaturgët shqiptarë që të konkurrojnë me dramat e tyre në Konkursin për Dramë Origjinale Shqipe “Katarina Josipi” për vitin 2021”.

Çmimet të cilat i ndanë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për çdo vit janë si në vijim:

1. Çmimi i parë për Dramë origjinale Shqipe “Katarina Josipi”
2. Çmimi i dytë për Dramë origjinale Shqipe “Katarina Josipi”
3. Çmimi i tretë për Dramë origjinale Shqipe “Katarina Josipi”

Vlerësimin për ndarjen e çmimeve e bën juria profesionale e përbërë nga 5 anëtarë e emëruar nga Ministri.

Tri Çmimet për dramat më të mira, jepen në të holla, të shoqëruara nga një certifikatë të nënshkruar nga Ministri dhe një kopje origjinal të vendimit.

Çmimet dorëzohen në një ceremoni të veçantë të organizuar nga MKRS, me 9 nëntor në ditëlindjen e “Katarina Josipit”.

Tri dramat fituese botohen në një edicion special në gjuhën shqipe;

Kriteret dhe kushtet për pjesëmarrje

- Laureat të Çmimit mund të jenë dramaturgët që janë shtetas të Republikës së Kosovës.
- Një autor mund të sjellë më së shumti dy drama për shqyrtim;
- Dramat që konkurrojnë në këtë konkurs duhet të jenë jo më të shkurtra se 50 minuta;
- Dramat e të gjitha zhanreve do të merren në shqyrtim;
- Tema dhe as numri i personazheve nuk janë të limituara;
- Dramat e papërfunduara apo sinopsiset nuk do të merren në shqyrtim;
- Dramat që sillen në këtë konkurs duhet të jenë origjinale, të shkruara mbas vitit 2000, dhe nuk duhen të jenë të inskenuara apo të botuara më parë;
- Drama që fiton vendin e parë, konsiderohet si dramë potenciale për t'u inskenuar në njërin nga sezonet e ardhshëm në TKK;
- Dramat që shpërblehen për vendin e dytë dhe të tretë, fitojnë të drejtën për lexime skenike në TKK;
- Dramat dorëzohen në tri kopje me mbishkrimin “Konkursi për Dramë Kombëtare ‘Katarina Josipi 2021’” ;
- Autorët duhet të nënshkruhen me shifër dhe shifrat fituese do të shpallen në media për konfirmimin e emrave të fituesve. Për konfirmim të shifrës, autori duhet të sjell si dëshmi dramën origjinale.
- Dramat duhen të dërgohet në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrën nr. 022 (Adresa: MKRS, 10.000 Prishtinë, Rruga “Nëna Terezë” nr. 35).
- Autorët që sjellin dramat e tyre në këtë konkurs konsiderohet se i pranojnë kushtet e këtij konkursi.

Konkursi do të jetë i hapur nga dita e publikimit në medie deri me 21 Shtator 2021. Çdo Dramë e ardhur mbas kësaj date nuk do të merret në shqyrtim.

Kërkesat e autorëve me dokumentacion jo të kompletuar nuk do të shqyrtohen.